

  
REPUBLIKA E SHqipëRISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

---

Nr. 759 Vendimi

DT.20.09.2019

**V E N D I M**

**“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË, E PËRBËRË NGA:**

**ENEIDA CIVICI – GJYQTARE**

Sot me datë **20.09.2019**, përfundoi çështjen civile, që i përket:

**KËRKUES:** AKADEMIJA ALTERNATIVE SHKENCORE RRENJET TONA, paraqitur nga Sazan Guri.

**OBJEKTI:** Rregjistrimin në regjistrin e organizatave jofitim prurëse të Fondacionit " AKADEMIJA ALTERNATIVE SHKENCORE RRENJET TONA " .

**BAZA LIGJORE:** LIGJI 7850 date 29.07.1994 i Kodit Civil; Ligji nr.8788 date 07.05.2001 "Per organizatat jofitimprurëse" Ligji Nr 8789 date 07.05.20101 "Per regjistrimin e organizatave jo Fitimprurëse".

**V Ë R E N**

1.Me kerkesen drejtuar kesaj Gjykate, kerkuesi, kërkon rregjistrimin në regjistrin organiuztave jofitimprurëse të Fondacionit " AKADEMIJA ALTERNATIVE SHKENCORE RRENJET TONA " .

**Nga provat shkresore te paraqitura nga ana e pales kerkuese dhe aktet e depozituara ne Gjykate, rezultoi e provuar se:**

2. Fondacioni "AKADEMIJA ALTERNATIVE SHKENCORE RRENJET TONA" , është krijuar nga themeluesit Sazan Guri, Stefan Pinguli, Frederik Balaj sipas aktit noterial nr.4106 rep. Nr.1516 kol datë 21.06.2019 të noteres Mimoza Shehu.

3.Bazuar ne aktin e themelimit, statutin e miratuar rezulton se qëllimi i fondacionit eshte: "Veprimtaria e Fondacionit "Akademia Alternative Shkencore Rrënjet Tona" në kuptimin juridik, dhe/ose atij të specializuar në kuptimin shkencor do të përqëndrohet në këto fusha:

- 
- a. Historiografi, Gjuhësi, Etnokulturë, Ekonomi patriotike, Turizëm historik dhe Inxhinieri dhe degë të tjera që lidhen me shkencën Albanologjike për të cilat do të krijohen këto departamente më vete operimi dhe pune, me qëllim informimin dhe vënien në dispozicion të subjekteve të ndryshëm shtetërorë e privatë, të publikut të gjerë vendas e të huaj e të organeve të pushtetit qendror e lokal, studime, projekte dhe konsulta në fushat e mësipërme që do t'iu shërbejnë atyre për të hartuar programe zhvillimi afatshkurtëra, afatmesëm e afatgjata.
  - b. Fondacioni , si Institucion i specializuar me departamentet e saj, e organizuar në nivel Akademie alternative do të sjellë fakte e interpretime, sesi mund të ndihmojë historia për të siguruar lirinë e vërtetë të mendimit dhe të shprehjes dhe të bëhemi pjesë dinjitoze e komuniteti vleror që quhet Europë.
  - c. Nxitjen e iniciativave për problemet në fushat e historisë, kulturës, si dhe përfaqësimin si institucion i specializuar, (duke pasur në përbërje të vet ekspertë historianë, arkeologë, gjuhëtarë, etnokulturorë, ekonomist, inxhinierë), të interesave të qytetarëve për këto çështje në proceset vendimmarrëse dhe në instancat gjyqësore në mbrojtje të interesit publik e kombëtar në dobi të shkollave, te arsimit, metodave studimore, duke ringritur debatin e munguar shkencor në keto fusha për zbulimin e se vërtetës.
  - d. Synimin për të ndërgjegjesuar shqipëtarë-arbërit kudo që ndodhen, për rëndësinë e njohjes së origjinës sonë, për të kuptuar peshën e kësaj vlere historike në shkallë kombëtare e ndërkombëtare, për të marrë përsipër përgjegjësinë e kësaj peshe si trashëguesit dhe mbartësit themelor e të drejtpërdrejtë të tyre.
  - e. Rritja e vetëdijes së shqiptarëve mbi rëndësinë e njohjes së lidhjeve të historisë së tyre me kulturat e antikitetit.

Organet drejtues i fondacionit janë Bordi i Drejtorëve i përbërë nga: Stefan Pinguli, Fred Balaj, Fatbardha Demi, Anastas Shuke, Astrit Memia.

**Organi ekzekutiv** i Fondacionit është Drejtori Ekzekutiv. Drejtor i parë Ekzekutiv i Fondacionit është: Z.Sazan Guri.

**Kohëzgjatja** e veprimtarisë së Fondacionit do të jetë për një afat të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin e Organizatave Jo fitimprurëse.

**Selia** e fondacionit dotë jetë në adresën: Rr. "Zef Jubani", Pall. Bjorn, Ap. 62, k-8, Tiranë, Shqipëri.

Sipas mandat pagesës datë 04.02.2019 rezulton derdhur në bankë si kapital për fondacionin shuma 100.000 lekë.

Gjykata konstaton se krijimi i fondacionit është në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit nr.8788 date 07.05.2001 "Per organizatat jofitimprurëse".

**Për këto arsye**

TIRANE

Bezuar në ligjin 7850 date 29.07.1994, Ligjin nr.8788 date 07.05.2001 "Per organizatat jofitimprurëse", Ligji Nr 8789 date 07.05.2001 "Per regjistrimin e organizatave jofitimprurëse",

**VENDOSA**

1. Pranimin e kerkeses.
2. **Regjistrimin** në regjistrin e si person juridik të fondacionit " AKADEMIA ALTERNATIVE SHKENCORE RRENJET TONA ".
3. **Depozitim** në regjistrin e organizatave jofitim prurëse të aktit të themelimit, statutit të fondacionit " AKADEMIA ALTERNATIVE SHKENCORE RRENJET TONA ".
4. Kundër ketij vendimi ligji nuk parashikon ankim.

**Tirane me date 20.09.2019**

**GJYQTARE  
ENEIDA CIVIC**

